РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА КВАЛИТЕТ ВО ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ

Кеј Димитар Влахов 4, II спрат
Центар, Скопје
Тел. 02/3220509

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR CILËSI NË ARSIMIN E LARTË

Dimitar Vlahov 4, kati II
Qendër, Shkup
Tel. 02/3220509

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
АГЕНЦИЈА ЗА КВАЛИТЕТ ВО ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ
AGJENCIA PËR CILËSI NË ARSIMIN E LARTË
Бр.-Nr. 08-510/4
07-06 20 22 год.-viti
Скопје - Shkup

Врз основа на член 145 став (6) и член 227 од Законот за високото образование („Службен весник на Република Македонија" бр. 82/18 и „Службен весник на Република Македонија" бр.178/21), директорот на Агенцијата за квалитет во високото образование, донесе

## Р Е Ш Е Н И Е

**за почеток со работа на студиската програма од втор циклус на академски студии - постдипломски студии (120 ЕКТС) по „Граѓанско право" на Правен факултет при Универзитет на Југоисточна Европа - Тетово**

1. Со ова решение се утврдува дека се исполнети условите за почеток со работа на студиската програма од втор циклус на академски студии - постдипломски студии (120 ЕКТС) по „Граѓанско право" на Правен факултет при Универзитет на Југоисточна Европа - Тетово.

2. Ова решение влегува во сила со денот на донесување.

## О б р а з л о ж е н и е

По добивање на Решение за акредитација бр.08-963/4 од 25.05.2022 година од страна на Одборот за акредитација на високото образование, Универзитет на Југоисточна Европа - Тетово се обрати со барање бр.03-1625/2 од 31.05.2022 година, до Агенцијата за квалитет во високото образование, под наш бр. 08-510/1 од 31.05. 2022 година, за утврдување на условите за

Mbi bazë të nenit 145 paragrafi (6) dhe neni 227 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.82/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.178/21), drejtori i Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë, sjell

## A K T V E N D I M

**për fillimin me punë të programit studimor të ciklit të dytë të studimeve akademike - studime pasdiplomike (120 SETK) nga "E drejta civile" në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë**

1. Me këtë Aktvendim përcaktohet se janë plotësuar kushtet për fillim me punë të programit studimor të ciklit të dytë të studimeve akademike - studime pasdiplomike (120 SETK) nga "E drejta civile" në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë.

2. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

## A r s y e t i m

Pas marrjes së Aktvendimit për akreditim nr.08-963/4 të datës 25.05.2022 nga ana e Bordit për Akreditim të Arsimit të Lartë, Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë i drejtohet, me kërkesë nr. 03-1625/2 të datës 31.05.2022, Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë, me numrin tonë 08-510/1 të datës 31.05.2022, për përcaktimin e kushteve për fillimin me punë të programit studimor të ciklit të dytë të studimeve

Кеј Димитар Влахов 4, II спрат
Центар, Скопје
Тел. 02/3220509

Dimitar Vlahov 4, kati II
Qendër, Shkup
Tel. 02/3220509

почеток со работа на студиската програма од втор циклус на академски студии - постдипломски студии (120 ЕКТС) по „Граѓанско право“ на Правен факултет при Универзитет на Југоисточна Европа - Тетово.

Директорот на Агенцијата за квалитет во високото образование, со Решение бр.08-510/2 од 31.05.2022 година, формира Комисија за утврдување на исполнетоста на условите за почеток со работа на студиската програма наведена во точка 1 на ова решение.

Комисијата, на ден 02.06.2022 година, изврши увид и изготви Извештај бр. 08-510/3 од 06.06.2022 година, каде е наведено дека за студиската програма од втор циклус на академски студии - постдипломски студии (120 ЕКТС) по „Граѓанско право“ на Правен факултет при Универзитет на Југоисточна Европа - Тетово, се исполнети условите согласно одредбите утврдени со Законот за високото образование и Уредбата за нормативи и стандарди за основање на високообразовни установи и за вршење на високообразовна дејност („Службен весник на Република Македонија“ бр. 103/10, 168/10 и 10/11).

Имајќи го во предвид изнесеното, се одлучи како во диспозитивот на ова решение.

**ПРАВНА ПОУКА**: Против ова решение, може да се заведе управен спор, со поднесување на тужба до Управниот суд на Република Северна Македонија, во рок од 30 дена од денот на приемот на ова решение.

Доставено до:
- Високообразовната установа
- Архива

изработил/përgatiti: Милена Ефремовска
одобрил/miratoi: Севгил Муртези

akademike - studime pasdiplomike (120 SETK) nga "E drejta civile" në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë.

Drejtori i Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë, me Aktvendim nr.08-510/2 të datës 31.05.2022, formoi Komision për përcaktimin e kushteve për fillimin me punë të programit studimor të shënuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi.

Komisoni, më 02.06.2022, kreu inspekimin dhe përgatiti Raportin me nr. 08-510/3 të datës 06.06.2022, ku është shënuar se, për programin studimor të ciklit të dytë të studimeve akademike - studime pasdiplomike (120 SETK) nga "E drejta civile" në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë, janë përmbushur kushtet, në përputhje me dispozitat e përcaktuara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për normativin dhe standardet për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë si dhe për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/10, 168/10 dhe 10/11).

Duke marrë parasysh atë që u theksua, u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE**: Kundër këtij Aktvendimi, mund të inicohet kontest administrativ, me parashtrimin e ankesës deri te Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Dorëzuar deri te:
- Institucioni i arsimit të lartë
- Arkivi

**ДИРЕКТОР/ DREJTOR**
**Dr. Agim Rushiti**